

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasje të trefishtë ndërgjegjëse, parandaluese dhe ndëshkuese;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2019 të Komisionit Evropian për progresin e shënuar nga Inspektorati në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, si dhe sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2019 në drejtim të:

Performancës në rritje për zbulimin e rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave private, duke administruar një numër total prej 3679 deklaratash të interesave private, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private të 1417 subjekte deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, për rastet e mosdeklarimeve dhe për rastet e konfliktit të interesit 54 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 115 raste referimesh penale.

Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, nëpërmjet angazhimit të pjesës më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale, duke përfunduar verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura në deklaratat e pasurisë vetëm për vitin 2019 për 220 subjekte të rivlerësimit dhe duke dorëzuar dokumentacionin e plotë për pjesën tjetër të gjyqtarëve të gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda si dhe prokurorët e prokurorive të apelit dhe Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda.

Administrimit dhe analizimit të 391 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 147 i përkasin sektorit publik dhe 244 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në dispozitat e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe nga ku është konstatuar se vetëm 3 njësi përgjegjëse kanë sinjalizuar dhe trajtuar raste sipas ligjit.

Regjistrimit dhe trajtimit, në funksion të kompetencave që i jep ligji Inspektoratit si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizim, të 14 rasteve sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje.

Zhvillimit të një sërë aktiviteteve trajnuese dhe informuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, si: OSBE-në, Këshillin e Evropës etj., me qëllim rritjen e kapaciteteve të njësive përgjegjëse të sektorit publik dhe privat për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e

sinjalizuesve, si dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me mekanizmat e luftës kundër korrupsionit, në të cilat kanë marrë pjesë mbi 500 anëtarë të njësive përgjegjëse.

Bashkëpunimit të ngushtë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, ambasadën e SHBA-së dhe Prezencën e OSBE-së për përmbushjen e rekomandimit për kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës për ndërhyrjet e nevojshme ligjore në ligjin nr. 60/2016.

Ofrimit të asistencës teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse, si struktura kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit.

Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore 62 kërkesa të publikut për publikimin e 10937 deklaratave.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2020 të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të angazhohet për përmbylljen me sukses të procesit të dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme e të arsyetuara për pjesën e mbetur të subjekteve të rivlerësimit pranë organeve kompetente.

- Duhet të vijojë më tej bashkëpunimin me organet e reja të drejtësisë në drejtim të administrimit të deklaratave të pasurisë për subjektet candidate për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ushtrimit të kontrollit të pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare nga subjektet candidate dhe personave të lidhur me ta.

- Duhet të angazhohet më tepër në udhëzimin e këshillimin e njësive përgjegjëse për formën dhe të dhënat e nevojshme që duhen paraqitur në raportin vjetor për rastet e sinjalizimit, me qëllim orientimin drejt një raportimi në mënyrë cilësore dhe me standard të unifikuar, si dhe të intensifikojë monitorimin e veprimtarisë së tyre.

- Të vijojë ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile dhe forcimin e urave të bashkëpunimit me median investigative në drejtim të rritjes së transparencës institucionale për publikimin e deklaratave të interesave private dhe informimin e duhur në lidhje me mekanizmin e sinjalizimit.

- Të paraqesë së bashku me raportin vjetor të veprimtarisë edhe raportin për zbatimin e ligjit të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, ku të përfshihen numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimin dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve dhe zbatimin e mekanizmave të mbrojtjes nga hakmarrja.

- Të vijojë procesin e ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, duke siguruar plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor me aktet nënligjore për vënien në funksionim të këtij sistemi, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë së mëtejshme të funksionimit të vetë sistemit.

Miraturar në datën 28.5.2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi